**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

## SHKURT 2026

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 02.02.2026 | 1. VNM-ja e miratuar për ndërtimin e hidrocentral-eve Ura e Tamarës (HEC Kozhnjë 1, Kozhnjë 2 dhe Tamara) në pellgun ujëmbledhës të lumit të Cemit të Vuklit, Bashkia Malësi e Madhe, | 11.02.2026 | U vendos në dispozicion informacioni i kërkuar. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Qarku Shkodër.<br><br>2. Ju lutem, vendosni në dispozicion deklaratën mjedisore, procesverbal-in e dëgjesës publike dhe kontratën koncensiona-re. | | | | |
| 2. | 04.02.2026 | Kërkoj vënie në dispozicion të informacion-it dhe dokumentac-ionit zyrtar lidhur me lejen mjedisore dhe përputhshm-ërinë mjedisore të HEC-eve të ndodhur në pasuritë Berat.<br>1-Dokumentac-ion mjedisor. | 16.02.2026 | Në vijim të informacionit të kërkuar, Ju bëjmë me dije si vijon:<br>Subjekti "Vokopola Energji" sh.p.k, është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, për ndërtimin e kaskadës së HEC-eve, Vokopola 1, Vokopola 2, Vokopola 3, në përroin e Komarit dhe Vokopolës, Poliçan, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.<br><br>*Procedura është kryer në bazë të:<br>· Ligjit Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar<br>· VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" të ndryshuar.<br>*Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur vendimi:<br>· Në kontratën shtesë të koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim-Operim –Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Vokopla 1" & "Vokopla 2" "Vokopla 3", lidhur midis MIE-s dhe shoqërisë.<br>· Në Vendimin për VNM paraprake (aplikimi është bërë për rinovim të afatit 2 vjecar të vlefshmërisë së këtij Vendimi)<br>· Në Lejen Mjedisore | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2-Kopje të lejes mjedisore<br>3-VNM<br>4-Raporti i VNM<br>5-Akti i konsultimit publik<br>6-Kontroll dhe Monitorim<br>7-Procesverba-le inspektimi dhe monitorimi mjedisor<br>8-Vendime apo masa administrati-ve të marra për shkelje mjedisore<br>9-Statusi aktual<br>10-Informacion nëse objekti aktualisht është në funksion nga pikëpamja mjedisore<br>11-Nëse janë | | Të dhëna teknike: Fuqia totale e instaluar: 5675 KW<br>Gjithashtu subjekti ka deklaruar në AKM se është pajisur me Leje Ndërtimi, për objektin "Ndërtimin e Hidrocentralit " Vokopola 1", Vokopola 2", Vokopola 3", Bashkia Skrapar, Polican, dhe Memaliaj.<br>Ju sjellim në vëmendje se bazuar në Ligjin Nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar:<br>•KREU I, Neni 1, Pika a) qëllimi i tij është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim.<br>•KREU II, Neni 7, Pika 1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.<br>•KREU V, Neni 20, Pika 1. Autoriteti i planifikimit ose autoriteti përgjegjës për licencimin, kur shqyrton dhënien ose jo të lejes së zhvillimit/licencës përkatëse për një projekt, apo vendosjen e kushteve për zhvilluesin, merr në konsideratë vendimin dhe deklaratën mjedisore për ndikimet në mjedis të projektit të propozuar.<br><br>Bashkelidhur gjeni dokumentacion.<br><br>Sa i përket kontrollit, nga kontrolli në bazën e të dhënave, rezulton se subjekti "Vokopola Energji", është inspektuar nga ARM Berat-Elbasan- Korçë, dhe ndaj tij është marrë masë administrative gjobë në vlerën 1.2000.000 Lekë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | konstatuar shkelje të kushteve të lejes mjedisore | | | | |
| 3. | 03.02.2026 | 1. Ju lutem, vendosni në dispozicion VNM-të e miratuara për ndërtimin e hidrocentraleve:<br><br>Bushtrica 1 (Elenergji shpk), Bushtrica 2 (Bushtrica 2017 shpk) dhe Bushtrica 3 (Bushtrica<br><br>Hydropower shpk) në Bashkinë Përrenjas.<br><br>2. Ju lutem, për të tre hidrocentral-et e mësipërme vendosni po | 18.02.2026 | Në vijim të materialit të kërkuar, për projektet e HEC Bushtrica 1, Bushtrica 2, dhe Bushtrica 3, ju bëjmë me dije se:<br><br>Subjekti Bushtrica 2017 Sh.p.k, është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, në 2024<br>Subjekti Elenergji Sh.p.k, është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, në 2024<br>Subjekti Bushtrica Hydropower Sh.p.k, nuk është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, është refuzuar në 2024. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ashtu në dispozicion:<br><br>a.) deklaratën mjedisore,<br><br>b.) procesverbal-in e dëgjesës publike dhe<br><br>c.) kontratën koncensiona-re. | | | | |
| 4. | 04.02.2026 | A është pajisur me leje mjedisi ose deklaratë mjedisore kanali vaditës Zhulat – Taroninë?<br><br>· Nëse po, ju lutem të na vini në dispozicion kopje të lejes/deklaratës mjedisore. | 06.02.2026 | Në lidhje me kërkesën tuaj ju informojmë se:<br><br>1. Nga verifikimi në databasë nuk rezulton të jetë dhënë VNM Paraprake/Deklaratë Mjedisore për projektin e kanalit vaditës Zhulat – Taroninë.<br><br>2. Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C janë të publikuara në regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë".<br>Në linkun e mëposhtëm mund të verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B:<br>https://qkb.gov.al/licencat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/<br><br>3. Në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi periudha 2014 - 2025: | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 1. https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/<br><br>Për një informacion më të saktë mbi operatorët të pajisur me leje mjedisi Ju duhet t'i drejtoheni QKB-së e cila mban dhe administron regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave. | | |
| 5. | 05.02.2026 | 1. Si është e mundur që kompani të palicencuara ose pa kapacitet ligjor për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme të përfshihen në transportin dhe eksportin e tyre?<br><br>2. Cili institucion ka përgjegjësi-në për verifikimin e licencimit të subjekteve | 19.02.2026 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit bazuar në VKM-në Nr.568, datë 17.07.2019 "Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" ka në funksionalitetin e saj ndër të tjera shqyrtimin e aplikimeve për Leje Mjedisi dhe VNM/Monitorimin dhe Inspektimin e zbatimit të kushteve të tyre sipas:<br>Ligjit Nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar;<br>Ligjit Nr.10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar;<br>Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis",<br>Urdhër Nr.29, datë 30.08.2023 "Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushën e veprimtarisë inspektuese të mjedisit për IKMT-në dhe AKM-në.<br>Procedura e shqyrtimit kryhet në zbatim të:<br>-VKM-së Nr.419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a dhe b, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB", e ndryshuar;<br>-VKM Nr.686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", e ndryshuar.<br>Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryen kontrolle periodike duke verifikuar zbatimin e kushteve për të gjithë subjektet e | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | që merren me mbetje të rrezikshme dhe a është kryer ky verifikim në këtë rast?<br><br>3. Kush mban përgjegjësi institucionale për faktin që këto mbetje janë klasifikuar dhe trajtuar në mënyrë të pasaktë?<br><br>4. A ka pasur kontrolle periodike nga Agjencia ndaj subjekteve të përfshira dhe çfarë kanë konstatuar ato?<br><br>5. A janë pezulluar ose | | licencuar dhe bën propozime për pezullim apo revokim pranë ministrit përgjegjës për mjedisin në rast shkelje.<br>Në rastin konret, ka patur kontrolle periodike cdo vit dhe për dy nga subjektet gjeneruese të këtyre mbetjeve ka masa gjobë për arsye të menaxhimit të mbetjeve jo konform legjislacionit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | revokuar licencat e subjekteve që rezultojnë të përfshira në këtë çështje? Nëse jo, pse?<br><br>6. Çfarë masash konkrete do të marrë Agjencia Kombëtare e Mjedisit për të garantuar që raste të ngjashme të mos përsëriten në të ardhmen? | | | | |
| 6. | 06.02.2026 | 1. Cila do të jetë procedura teknike e asgjësimit të lëndëve të rrezikshme të depozituara në “Porto Romano”. | 19.02.2026 | Në vijim të informacionit të kërkuar ju bëjmë me dije si vijon:<br><br>1-Sa i përket procedurës teknike do të veprohet sipas metodologjive të miratuara nga institucionet respektive në varësi të specifikimeve teknike, pas analizimit të llojit të mbetjeve.<br>2-Nisja e procedurës është në varësi të rrjedhës së hetimeve.<br>3-Në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, do të merrn masa për uljen e ndikimit të faktorëve të jashtëm.<br>4-Sa i përket përmbushjes së nenit 12 të ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”, do të bashkepunohet me Agjencinë e Menaxhimit të | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Kur parashikohet të nisë procedura?<br><br>3. Sa rrezik ka qëndrimi për një kohë të gjatë e mbetjeve për ndotjen e mjedisit përreth? A janë respektuar të gjitha kriteret në ruajtjen e deritanishme?<br><br>4. Ligji parashikon që dëmin e shkaktuar në mjedis e paguan ndotësi, sipas parimit "ndotësi paguan" i parashikuar në nenin 12 të ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit". A keni | | Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pas vendimit të gjykatës dhe ligjit në fuqi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komunikuar me Kurum për këtë çështje? Cila janë procedurat që parashikohen? A do të pritet një vendim i formës së prerë? Sa e dëmton kjo mbrojtjen e mjedisit? | | | | |
| 7. | 10.02.2026 | Kam bërë një ankesë kundrejt subjektit G*** shpk përsa i përket mbetjeve plastike që ky subjekt punon, mora një pergjigje nga ana juaj që subjekti kishte shkelje të masave administrati-ve dhe që ka dorëzuar | 20.02.2026 | Brenda kompetencave funksionale trajtuar nga ARM Berat/Elbasan/Korçë, Ju bëjmë me dije si vijon :<br><br>Në datë 17-18.02.2026 në ambjentet ku subjekti kryen aktivitet, u krye process-verifikim. Subjekti po kryente aktivitet. Nga dokumentat e vëna në dispozicion, nga përfaqësuesja e subjektit subjekti është i pajisur me leje mjedisi tipi B , me datë lëshimi 06.04.2022. Në përmbushje të zbatimit të kushteve të lejes subjekti kishte kryer Raportin Vjetor të Mjedisit,( periudha Prill 2024 – Prill 2025) Raportin 6-mujore të monitorimit ( periudha Prill 2025 – Tetor 2025), me studio të licensuar&akredituar. Referuar matjeve të kryera shkarkimet e kryera ishin brënda normave të lejuara. Mbetjet e krijuara gjatë proçesit të prodhimit të shuallit, rikthehen në proçesin e prodhimit.Ky proces realizohej në repartin e riciklimit, ku të gjitha mbetjet e gjeneruara riktheheshin në formën e lëndës së parë, në formë granule.<br><br>Për depozitimin e mbetjeve që gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit, me Kod 20 03 01 dhe 20 03 99 disponononte Kontrat | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumentac -ionin e tij, dhe ju më keni thënë që do ngelemi në kontakt ,,, pyetja ime është: A po vazhdon ky subjekt të permbush detyrat dhe dokumentac ionin qe i perket ligjit? | | shërbimi me Shoqërinë KRWM sh.a ( lidhur në Dt.19.01.2026)<br><br>Për transferimin e mbetjeve, disponon "Marrëveshje" me subjektin KRIKET – 1 sh.p.k (lidhur në Dt.01.01.2026)<br><br>Kishte plotësuar dhe dorëzuar në AKM Regjistrin e transferimit të mbetjeve dhe formularët e transferimit të mbetjeve.( bashkëngjitur formularin e trasferimit të ngarkesës së fundit)<br><br>Në përfundim trupa inspektuese konkludon se subjekti kryen aktivitetin në përmbushje të detyrimeve të kushteve të Lejes s ë Mjedisit. | | |
| 8. | 12.02.20 26 | A ka AKM-ja informacion nëse subjektet që po marrin zhavor/der-dhin inerte apo punojnë në brendësi të lumit Shkumbin në projektin për zgjerimin e rrugës Elbasan-Qafë Thanë janë të licencuara | 24.02.2026 | Në vijim të informacionit të kërkuar, ju bëjmë me dije si vijon:<br><br>1-Kjo pike është në kompetencën e Agjencisë Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU-së). Lejen e Shfrytëzimit të Burimeve ujore/ apo ndertimore ne Brigje jane ne kompetence te Agjencisë Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU-së).<br>referuar kësaj pike është Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore (AMBU) institucioni kompetent.<br>2-Referuar kësaj pike është Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore (AMBU) institucioni kompetent.<br>3-Koordinatat e lejuara, miratuara jepen nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë (MIE).<br><br>Sa i përket procedurës së inspektimeve :<br>Lidhur me informacionin e kërkuar, në bazë të inspektimeve të kryera, sektori i inspektimit të Burimeve Natyrore ka kryer 1 (një) inspektim në lidhje me subjektet që punojnë për projektin e rrugës Elbasan- Qafë Thanë. Inspektimi është realizuar si pasojë e indicies të marrë nga pale të treta. Nga inspektimi i kryer rezultoi se subjekti G*** shpk shfrytëzonte inerte nga | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për shfrytëzim inertesh?<br><br>2. Cilat janë kompanitë e pajisura me leje për shfrytëzim inertesh apo ndërhyrje në lumin Shkumbin për projektin për zgjerimin e rrugës Elbasan-Qafë Thanë?<br><br>3. Cilat janë koordinatat e lejuara/mirat-uara për të devijuar rrjedhën e lumit Shkumbin, apo nxjerrjen e zhavorrit?<br><br>4. A ka kryer AKM-ja | | shtrati i lumit shkumbin pa lejen perkatese nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore. Lidhur me shkeljen e konstatuar ndaj subjektit është vendosur masa e dënimit administrativ me gjobë 1 000 000 lekë, si dhë Vendimin e Ndërmjëm për Marrjen e Masës Urgjente për pezullimin e veprimtarisë së marrjes së inerteve lumore . | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | monitorime në terren gjatë periudhës kur po kryhen punimet? Nëse po, kur është kryer inspektimi i fundit në zonën ku po ndërhyhet në lumin Shkumbin?<br><br>5. Nëse keni kryer inspektim, cilat janë gjetjet tuaja? A janë konstatuar shkelje për devijim të rrjedhës së lumit, derdhje të inerteve në shtrat dhe nxjerrjen e zhavorit jashtë koordinata-ve të miratuara? | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6. A ekziston një raport për ndikimin e këtyre punimeve në cilësinë e ujit, biodiversite-tit dhe rrezikun e përmbytjes? | | | | |
| 9. | 12.02.2026 | Për periudhën Janar – Dhjetor 2025:<br>1.Numrin e operatorëve të biznesit ushqimor (OBU) të ndryshëm që kanë njoftuar AKM për procedura asgjësimi të produkteve ushqimore me origjinë shtazore;<br>2.Numrin e njoftimeve të bëra ndaj AKM për procedura asgjësimi të | 24.02.2026 | Në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi, ligjit Nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ligjit Nr.10448/2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Vendimin Nr.402/2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, VKM Nr.229/2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, VKM Nr.371/2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezkishme dhe të dokumentit të dorezimit të tyre”, VKM Nr.568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br>1-Numri i subjekteve të ndryshëm që kanë njoftuar AKM për procedura asgjësimi të produkteve ushqimore me origjinë shtazore është 33.<br>2-Numri i njoftimeve të bëra ndaj AKM për procedura asgjësimi të produkteve ushqimore me origjinë shtazore nga AKU është 0.<br>3-Numri total i procedurave faktike të asgjësimit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të dokumentuara nga strukturat e AKM është 22.<br>4-Sasia totale (në kg/ton) të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të asgjësuara sipas këtyre procedurave është 56237.4 kg.<br>5-Mënyra e asgjësimit të tyre sipas rrymave të mbetjeve është përmes industrisë së përpunimit si dhe depozitimit në landfill. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | produkteve ushqimore me origjinë shtazore nga AKU;<br>3.Numrin total të procedurave faktike të asgjësimit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të dokumentua-ra nga strukturat e AKM.<br>4.Sasitë totale (në kg/ton) të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të asgjësuara sipas këtyre procedurave;<br>5.Mënyrën e asgjësimit të tyre (përmes industrisë së përpunimit apo depozitimit në landfill); | | 6-Mbetjet të cilat nuk janë trajtuar përmes industrisë së përpunimit janë dorëzuar në landfill industrial të pajisura me impiant, leje, licenca dhe kodet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.<br>7-Në muajin Janar është kryer 1 procedurë, Shkurt 1 procedurë, Mars 1 procedurë, Prill 3 procedura, Maj 3 procedura, Qershor 1 procedurë, Korrik 4 procedura, Gusht 3 procedura, Shtator 1 procedurë, Tetor 1 procedurë, Nëntor 1 procedurë dhe Dhjetor 2 procedura. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6.Në cilat landfill-e janë depozituar këto produkte, në rastet kur është ndjekur kjo mënyrë dhe sasitë përkatëse;<br>7.Nëse është e mundur, ndarjen e këtyre të dhënave sipas muajve dhe sipas rajoneve. | | | | |
| 10 | 16.02.2026 | Për basenet kryesore ujore:<br><br>· Vjosë<br><br>· Devoll<br><br>· Drin<br><br>· Shkumbin<br><br>· Seman<br><br>· Mat | 24.02.2026 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit të gjithë informacionin e grumbulluar në zbatim të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, i cili hartohet sipas VKM Nr. 1189 datë 18.11.2009 për "Rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit", e afishon në faqen e web-it sipas linkut: https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/.<br><br>Ligji Nr. 29/2024 "Për burimet ujore" (ndryshuar me ligjin Nr.99/2024, datë 12.9.2024), përcakton funksionet edhe detyrat e secilit institucion mbi basenet ujore).<br><br>Sa i përket kontrolleve, ju informojmë se AKM qendër dhe rajone, sektori i inspektimit të burimeve natyrore (ujëra) e ushtron veprimtarinë e tij bazuar në: | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 - Kërkoj të më vihen në dispozicion informacio-ni dhe dokumentat e mëposhtëm për 5 vitet e fundit:<br><br>· Raportet e Monitorimit të ndikimit mjedisor<br><br>· Raportet për turbullimin e ujërave, degradimin e habitateve<br><br>2 - Për këto basene ujore, a ka kryer Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU)<br><br>· Kontrolle për ndërhyrje në | | Ligjin Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligjin Nr. 29/2024, datë 12.09.2024 "Për Burimet Ujore"<br>VKM. Nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit<br>Në këtë kuadër strukturat e inspektim-kontrollit kanë kryer inspektime edhe në shtretërit e lumenjve për aktivitete që ushtrohen pranë tyre dhe që janë të pajisur me leje përkatës (VNM dhe leje për shfrytëzimin e inerteve).<br>Më poshtë, po ju informojmë për këto inspektime:<br>Subjekti "I** spa", me aktivitet në brigje të lumit Shushicë, baseni Vjosë, ndaj të cilit është marrë masë administrative paralajmërim<br>Subjekti "HEC G**** 2", me aktivitet në brigje në lumin Devoll, baseni Vjosë, ndaj të cilit është marrë masë administrative gjobë 1.000.000 lekë<br>Subjekti "A**** Investments" me aktivitet në brigje në lumin Erzen, baseni Erzen, ndaj të cilit është marrë masë administrative gjobë 1.000.000 lekë<br>Subjekti "B**** Exspress" me aktivitet në brigje të lumit Erzen, baseni Erzen, ndaj të cilit është marrë masë administrative gjobë 1000 000 lekë<br>Subjekti "V**** Energji", me aktivitet në brigje të lumit Osum, baseni Seman, ndaj të cilit është vendosur dënim me gjobë<br><br>Subjekti "V*** Hysa", me aktivitet në lumin Devoll, baseni Seman, ndaj të cilit është vendosur dënim me gjobë<br><br>Subjekti "G***" shpk, me aktivitet lumi Shkumbin, baseni Shkumbin, ndaj të cilit është vendosur dënim me gjobë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shtratin e lumenjve<br><br>· A janë konstatuar shkelje dhe a janë administruar gjoba për mosrespektim kushtesh?<br><br>Nëse po, kërkoj të më vihen në dispozicion një kopje e gjobave të administruara.<br><br>3 - A jane evidentuar / raportuar:<br><br>· Gërryerje të shtratit të lumit (downstream erosion) në këto basene?<br><br>· Humbje të habitateve ujore për | | Subjekti "I****", lumi Shkumbin, baseni Shkumbin, me aktivitet në brigje ndaj të cilit është vendosur dënim me "Paralajmërim"<br>Subjekti "V**** shpk", me aktivitet në brigje lumi Mat, baseni Mat, është bërë inspektim me indicie nga palët e treta dhe është vendosur masë administrative 100.000 lekë, por është hequr me vendim të komisionit të ankimimit të AKM-së. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | këto basene ujore?<br><br>· Mungesë e ushqimit për speciet ujore në këto basene?<br><br>A ka rritje të turbullimit të ujërave gjatë reshjeve në këto basene?<br><br>A janë zhdukur specie peshqish apo shpendësh ujorë në zonat e sipërcituara? | | | | |
| 11. | 17.02.2026 | 1. A ka AKM të dhëna për ndotje bakteriale në Liqenin Artificial të Tiranës dhe baseneve të tjera ujore | 20.02.2026 | Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije si vijon:<br><br>1-Liqeni Artificial i Tiranës është futur në programin e monitorimit për vitin 2026, ku kampionet janë marrë në dy pika: 1. Shkarkimi i Kopshtit Zoologjik në liqen 2. Lake view point (përballë këndit të lodrave) Parametrat e monitoruar: temperatura e ujit, transparenca, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, TOC, | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në këtë bashki?<br><br>2. Sa herë është monitoruar cilësia e ujit në 5 vitet e fundit në Liqenin Artificial të Tiranës dhe basenet e tjera ujore në këtë bashki?<br><br>3. A ka masa të rekomandua ra që nuk janë zbatuar nga institucioin-et lokale? | | nitritet, nitratet, amonjaku, orto – fosfatet, Ptotal. AKM nuk kryen analiza bakteriale.<br><br>2-Bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit i cili hartohet në mbështetje të VKM Nr. 1189 datë 18.11.2009 për “Rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” pika B4.1. a-f , B4.2.a-b, Ç4-b, Agjencia Kombëtare e Mjedisit realizon monitorimin e ujërave sipërfaqësore në Shqipëri. Raportet janë të aksesueshme në faqen zyrtare të AKM www.akm.gov.al<br><br>3-Programi monitorimit siguron një bazë të dhënash të cilat përdoren në hartimin e Raportit të Gjendjes së Mjedisit, në hartimin e informacioneve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit. AKM identifikon cilësinë e ujërave, burimet e mundshme të ndotjes dhe njofton Pushtetin lokal me anë të shkresave zyrtare ku është identifikuar ndotja për të marrë masa të mëtejshme. | | |
| 12. | 19.02.20 26 | 1.Cili është interpretimi zyrtar i Ministrisë mbi nenin 5 të Aktit Normativ Nr. 8/2023 dhe kufijtë e delegimit normativ që | 24.02.2026 | Në përgjigje të kërkesës bëjmë me dije se:<br>Të gjithë operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C dhe licenca të nënkategorisë III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”.<br>Bashkëlidhur link:<br>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ai parashikon?<br><br>2. Si justifikohet përfshirja në Udhëzim e subjekteve “të lidhura ose jo me rrjetin publik të kanalizimeve”, kur Akti Normativ synon subjektet që nuk trajtojnë dhe shkarkojnë ujëra të patrajtuara?<br><br>3. A është hartuar opinion ligjor i brendshëm për përputhshm-ërinë e nenit 6 të Udhëzimit me Aktin Normativ?<br><br>4. A është kryer | | Gjithashtu ju informojmë se në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi periudha janar 2014- janar 2026:<br>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/.<br>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/.<br>Për një informacion më të saktë mbi operatorët të pajisur me leje mjedisi, Ju duhet t’i drejtoheni QKB-së e cila mban dhe administron regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve.<br><br>Në pyetjet e renditura, Drejtoria e Menaxhimit të të Dhënave Mjedisore, Kimikateve, Analizave Laboratorike dhe Inovacionit shprehet se vetëm pyetja 8 është në fushën tonë të përgjegjësisë, ku sqarojmë si më poshtë:<br><br>Në skemën e monitorimeve të cilesise se ujerave qe AKM realizon perfshihet edhe monitorimi i cilësisë së plazheve që konsiston ne **monitorimin mikrobiologjik te ujërave bregdetarë të larjes.**<br>Monitorimi kryhet në 123 stacione kampionimi qe prej vitit 2022, nga 119 qe ka qene per vitin 2021 në plazhet kryesore të bregdetit të tilla si: plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjiri i Lalzit, Kavajës, (Qerret, Spille), Divjakës, Semanit, Vlorës, (Zvërnec, Orikum), Palasës, Drimadhes, Dhërmiut, Jalës, Livadhes, Himarës, Qeparoit, Borshit, Lukovës, Sarandës, Ksamilit, Pogradecit, Linit, monitorim i cili realizohet pergjate sezonit turistik 15 Maj – 30 Shtator me 9 seri kampionimi, si dhe është realizuar inspektimi higjeno-sanitar per vleresimin mikrobiologjik të tyre.<br>Monitorimi ka qëllim të mbrojë shëndetin publik, nëpërmjet vlerësimit të ngarkesës bakteriale **ku burimi i ndotjes jane shkarkimet e ujerave urbane të patrajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktojnë ndotje të këtyre ujërave duke u reflektuar qarte edhe ne ngarkesat e larta mikrobiale te vleresuara ne pikun e sezonit duke sjelle si rrjedhoje edhe perkeqesim te cilesise se stacioneve te monitoruara.** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | analizë shkencore ose teknike që vërteton se impiantet individuale për subjekte të lidhura me UK përmirësojnë cilësinë e ujërave larëse?<br><br>5. A është kryer analizë e ndikimit kumulativ mjedisor të instalimit të qindra impianteve private?<br><br>6. A ekziston raport vlerësimi mjedisor që krahason modelin e trajtimit të centralizuar me modelin e trajtimit të | | Mostrat e ujërave bregdetarë të larjes analizohen për 2 tregues bakteriologjike:<br>1. *Intestinal Enterococci* (IE)<br>2. *Escherichia Coli (probabilisht E.coli)*<br>Raportet jane të aksesueshme në faqen zyrtare të AKM **www.akm.gov.al** | | |

